



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 989/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) paraqitur kundër Bardhosh Limani, për shkak të votimit dhe asistimit për dy persona, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 01.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën pretendohet se më datë 01.12.2013, në fshatin Gadime e Epërme, në qendrën e votimit me nr 1307/01R, Bardhosh Limani me nr personal 1234080080, me datë të lindjes 09.01.1995, ka votuar dhe më pas ka asistuar dy persona, njërin në vendvotimin numër 01R dhe tjetrin në 04R. Sipas parashtresës të ankesës rasti është i evidentuar në librin e votimeve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në qendrën e votimit me nr 1307/01r, në fshatin Gadime e Epërme, një qytetar i quajtur Bardhosh Limani ka votuar dhe ka asistuar dy persona, PZAP-i konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nuk janë ofruar prova për parregullsinë e pretenduar për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 989/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.